

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Igol® A

EMULSION BITUMINOZ ANIONIK, PA LËNDË MBUSHËSE

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Emulsion bituminoz i përgatitur me agjentë emulsifikues kimikë anionikë pa lëndë mbushëse, me fluiditet shumë të lartë.

PËRDORIMET

- Si prajmer
- Hidroizolim i mureve vertikale, themeleve dhe konstruksioneve në punime publike në përgjithësi
- Mbrojtje me kosto efikase e sipërfaqeve prej betoni, në përgjithësi, i aplikuar në 2 ose më shumë shtresa, në varësi të kërkesave të shërbimit

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aplikim shumë i lehtë, për shkak të fluiditetit të lartë të tij
- Me bazë uji dhe plotësisht pa tretës. Jo i djegshëm
- Me kosto efikase dhe trashësi e hollë shtrese
- Rezistencë ndaj kushteve të motit
- Nuk përmban fenole
- Gati për përdorim, nuk kërkohet përzierje ose ngrohje
- Ndërkapje dhe depërtim i shkëlqyer mbi sipërfaqet e përgatitura në mënyrën e duhur
- Mund të aplikohet përforcim me pëlhurë fibrash qelqi, rrjetë ose gjeotekstil midis shtresave

MIRATIME / STANDARDE

Miratur sipas UNE 104-231 (Lloji EA) DBI 2282.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

| | |
|--|--|
| Baza kimike | Emulsion bituminoz anionik, pa lëndë mbushëse |
| Ambalazhi | Kovë 5 kg dhe 25 kg |
| Ngjyra | Lëng i zi |
| Jetëgjatësia | 6 muaj nga data e prodhimit |
| Kushtet e magazinimit | Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata me temperatura midis +5°C dhe +30°C |
| Dendësia | ~ 0.9 deri në 1.1 kg/l |
| Përmbajtja e substancave të ngurta për peshë | ~ 60% |
| Viskoziteti | ~ 1 - 5 (në +20°C Brookfield Rut, spindle 1.20 r.p.m.) |

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

| | |
|------------------------|--|
| Konsumimi | ~ 0,600 - 0,800 kg/m ² në 2 shtresa, në varësi të porozitetit dhe absorbueshmërisë së nënshtresës mbi të cilën aplikohet. |
| Temperatura e mjedisit | Min. +5 °C / Max. +30 °C |

| | |
|-----------------------------------|--|
| Temperatura e nënshtresës | Min. +5 °C / Max. +30 °C |
| Koha e maturimit | ~ 24 orë Nuk nevojitet asnjë trajtim i posaçëm. Mos lejoni që materiali të lagët ndërsa është ende i freskët. |
| Koha e pritjes / mbiveshja | ~ 24 orë midis shtresave |

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, pa graso, pluhur, vajra, ndryshk, etj.
Mund të aplikohet mbi sipërfaqe të thata ose lehtësisht të lagështa.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Të gjithë kontaminuesit duhet të hiqen ose manualisht (me furçë ose duke i prerë, etj.) ose mekanikisht (rrymë uji ose rëre, etj.).

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Mund të aplikohet me furçë, rul ose pistoletë me spërkatje.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë të pastër menjëherë pas përdorimit, përpara se të jetë tharë produkti. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm me Sika® Colma Cleaner ose tretës me bazë benzine.

KUFIZIME

- Kur aplikohet si prajmer, mund të hollohet me deri ~ 20% ujë.
- Nuk ka kompatibilitet me emulsionet kationike dhe tretësirat acide.
- Nëse vërehet sedimentim tek ena, produkti mund të rikthehet në gjendjen e tij origjinale duke e trazuar mirë.
- Në mot të ftohtë, Igol® A rrit viskozitetin e tij dhe duhet të zbutet në dhoma të ngrohta përpara aplikimit.
- Mos aplikoni Igol® A në kohë me shi. Mos lejoni të lagët ndërsa është ende i freskët.
- Igol® A nuk ka tretës, kështu që nuk nevojiten masa paraprake gjatë përdorimit të tij. Megjithatë, në mjedise me shumë lagështi, tharja duhet të përshpejtohet me ventilim të mjaftueshëm.
- Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni me departamentin teknik të Sika-s.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Igol® A

Qershor 2019, Botimi 02.01

020706040010000001

IgolA-sq-AL-(06-2019)-2-1.pdf

